



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FAKULTETI I EKONOMISË
D E K A N I

Nr. 39/1 Prot.

Tiranë, më 17/02/2023

Drejtuar: Prof. Dr. Et'hem Ruka
Rektor i Universitetit "Luarasi"

Lënda:

Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimit të Fakultetit të Ekonomisë për vitin akademik 2024-2025


I nderuar Rektor,

Bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22.7.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe 3, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 135, në propozimet e Departamenteve të Financë-Bankës, të Administrim Biznesit dhe Ekonomiksit, Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë, në mbledhjen e tij të datës 17.02.2023, vendosi mbi miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimit të Fakultetit të Ekonomisë, për vitin akademik 2024-2025.

Gjeni ju lutem bashkangjitur vendimin përkatës.

D E K A N I

Prof. Asoc. Dr. Indrit BAHOLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FAKULTETI I EKONOMISË
D E K A N I

V E N D I M

Nr. 01 Datë 17.02 2023

“Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimit të Fakultetit të Ekonomisë për vitin akademik 2024-2025”

Bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22.7.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe 3, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 135, Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë, i mbledhur në datën __.__.2023, pasi diskutoi për propozimet e përcjella nga Departamentet e Financë-Bankës, Administrim Biznesit, Ekonomiksit, për kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit të Fakultetit të Ekonomisë, për vitin akademik 2024-2025,

V E N D O S I :

1. Në programet e studimit “Bachelor” në “Administrim Biznesi” dhe “Financë Bankë” pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:

- i. Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë vendit (të ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit).
- ii. Plotësojnë kriterin e notës mesatare minimale sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave.
- iii. Renditja e aplikantëve do të kryhet duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - a) 80% e notës mesatare aritmetike të shkollës së mesme, përfshirë provimet e maturës shtetërore;
 - b) dhe me 20% mesataren për lëndën me zgjedhje të maturës shtetërore.



Lënda me zgjedhje e maturës shtetërore është si vijon:

- > Ekonomi 10%
- > Anglisht 10%
- iv. Plotësojnë kriteret e tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Në programet e studimit “Master i Shkencave” në “Banka dhe Tregje Financiare” dhe “Menaxhim Ekzekutiv” pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:

- a. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
- b. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në Ekonomi apo diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në programe të ngjashme me fushën e Ekonomisë si: Financë, Shkenca Politike, Bussines Law, Inxhenjeri etj., së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MASR, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.
 - i. Kanë të drejtën e pranimit vetëm aplikantët nga fushat e mësipërme, njohuritë formuese të të cilëve konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 1/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre.
- c. Zotërojnë dëshmi të gjuhës angleze, Niveli B1, mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar, sipas përcaktimit të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

- a. Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;

- b. Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës.
3. Në programet e studimit “Master Profesional” si “Financë & Menaxhim Risku” dhe “Marketing & Reklamë” pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:
- a. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
- b. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në Drejtësi apo diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në programe të ngjashme me fushën e Ekonomisë si: Financë, Shkenca Politike; Diplomaci; Marrëdhënie Ndërkombëtare, Teknologji Informacioni dhe Inovacioni, Inxhenjeri etj., së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MASR, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.
- i. Kanë të drejtën e pranimi vetëm aplikantët nga fushat e mësipërme, njohuritë formuese të të cilëve konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 1/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

- a. Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;
- b. Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2024-2025.



Prof. Asoc. Dr. Indrit BAHOLLI